



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:134236

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05857947

P.nr. 165/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me sekretaren juridike Fatmire Podvorica si procesmbajtëse dhe bashkëpunëtorin profesional Muhamet Musliu, në çështjen penale kundër të pandehurës M. R. nga P., për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 5 nën. par. 3.1 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.292/202F, të datës 28.05.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 25.06.2024, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurori i Shtetit Ardiana Veseli dhe e pandehura, në të njëjtën ditë mori publikisht, shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura,

M. R., nga i ati H., nënës Z., mbiemri i vajzërisë së nënës J., e lindur me dt...., me nr. letërnjoftimi ..., me vendbanim në P., rruga "Xh. M.", e martuar nënë e katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, amvise, e gjendjes se mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

S E P S E

Me datë 01.04.2024, rreth orës 21:30 minuta, në rrugën "Xh. M.", në P., saktësisht në shtëpinë e tyre, e pandehura në kundërshtim me Ligjin Nr.08/L-185 për Parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, me qëllim e ka sulmuar fizikisht viktimën e ndjeshme-vajzën e saj të mitur A. R., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje fillimisht verbale pasi që e dëmtuara kishte dalë pa lejen e të pandehurës dhe ishte vonuar në qytet pasi kthehet në shtëpi në atë moment e pandehura e sulmon fizikisht duke e goditur dhe kapur në fytyrë, me të cilin veprim të dëmtuarës i ka shkaktuar dhimbje fizike dhe lëndime të lehta trupore, me dëmtim të përkohshëm për shëndetin të përcaktuara me Akt-ekspertimin mjekoligjor, të datës 15.05.2024,-

-me këtë ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore të neneve 4, 7, 17, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe nenit 185 të KPRK-së, si dhe në bazë të 242, 364, 365, 367, 452 dhe 462 të KPPRK-së, të pandehur in e :

G J Y K O N

I. Të pandehurën me dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse e pandehura në afatin prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale.

II. Gjykata e liron të pandehurën nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale, ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të pandehurës ose të personave që ajo detyrohet ti mbështesë materialisht.

III. E dëmtuara A. R. nga P. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.292/202F, të datës 28.05.2024, kundër të pandehurës M. R. nga P., për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 5 nën. par. 3.1 KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 25.06.2024, gjatë të cilës prezantuan Prokurori i Shtetit Ardiana Veseli nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, dhe e pandehura M. R., ndërsa mungon e dëmtuara A. R. e cila është ftuar në mënyrë të rregullt nga gjykata..

E pandehura pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit deklaroi: E pranojë fajësinë, është e vërtete se me vajzën time kemi pasur një mosmarrëveshje, vajza ime nuk është mirë me shëndet dhe kur ka ndonjë problem nuk mund ta ndali me të mirë, ajo ka nevojë për tretman mjekësor, unë kujdesem për të dhe e dërgoj te mjeku, mirëpo ajo nganjëherë nuk pranon dhe nuk i përdor barnat e pastaj i keqësohet gjendja shëndetësore, nuk na dëgjon, unë vet i kam thirr policin, e lus gjykatën që duke pasur parasysh këto rrethana të më shqiptoi një dënim sa më të lehtë.

Prokurori i Shtetit Ardiana Veseli lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës sepse i njëjti është bërë me vullnetin e plotë nga e pandehura dhe bazuar në shkresat e lëndës. Pasi pranimi i fajësisë është në përputhje me dispozitat ligjore dhe ka bazë edhe me provat që gjenden në shkresat e lëndë, i propozoj gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë, dhe pranimin e fajësisë ta marr si rrethanë lehtësuese.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga e pandehura, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban Aktakuza, në materialet e prezantuar nga Prokurori i Shtetit, dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga e akuzuara, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.2 të KPPRK-

së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarës, kështu që e njëjta është penalisht përgjegjëse.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga vet të akuzuarës, gjykata vlerëson se në veprimet inkriminuese të akuzuarës përmbushën të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 5 nën. par. 3.1 KPRK-së, për çka gjykata gjeti se e akuzuara në aspektin penalo-juridik është përgjegjëse dhe të njëjtën e shpalli fajtores, andaj i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se e akuzuara në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e saj, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandalojë nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi lirimin nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në bazë të nenit 452 par. 4 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së,

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.165/24 me dt.25.06.2024.

Sekretare juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj Gjykate.